



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.663/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtare, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit politik G I Srbski Opstanak, me seli në Mitrovicën e Veriut, të paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me objekt të çështjes keqpërdorim i votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

HUDHET e palejuar ankesa Anr.663/2021 e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Subjektit politik G I Srbski Opstanak, me seli në Mitrovicën e Veriut, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak keqpërdorimit të votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2021, ka pranuar një ankesë Anr.663/2021 nga Subjektit politik G I Srbski Opstanak, në të cilën theksohet se për shkak të gjendjes faktike të vërtetuar gabimisht dhe përmbyshjes së vullnetit të votuesve, ne kërkojmë rinumërim të votave. Ne gjithashtu kërkojmë që nëse identifikohen mangësitë që ne pretendojmë, ti anuloni votat në ato vendvotime. Kutitë që duhet të numërohen përsëri për tu bindur për parregullsi.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli nuk është lëshuar fare në vlerësimin e pretendimeve ankimore, lidhur me shkeljet e pretenduar në ankesë përkitazi me parregullsitë, për faktin se shkeljet që ndërlidhen me rezultatin e votimit, duhet të parashtrihen me rastin e shpalljes së rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, e jo në këtë fazë të procesit zgjedhor.

Në rastin konkret nga KQZ-ja, nuk është marrë vendimi përfundimtar mbi shpalljen e rezultatit përfundimtar, andaj Paneli vendosi që ta hudhë si të parakohshme ankesën e ankueses. Hudhja e ankesës së Subjektit politik G I Srbski Opstanak nuk e paragjykon çështjen dhe ankueses nuk i mohohet e drejta që mbi këtë bazë, të paraqes ankesa tjera, pas shpalljes të rezultatit përfundimtarë nga KQZ-ja.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.663/2021 më datën 20.10.2021

Kryesuesi i Panelit
Ferki Xhaferi

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.*

